UDHËZIM
Nr.12/3, datë 4.7.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.12, DATË 18.5.2011 "PËR PROCEDURAT E ZBATIMIT TË LIGJIT NR.10 418, DATË 21.4.2011 "PËR LEGALIZIMIN E KAPITALIT DHE FALJEN E NJË PJESE TË BORXHIT TATIMOR DHE DOGANOR""

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr.10 418, datë 21.4.2011 "Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor", Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.12, datë 18.5.2011 "Për procedurat e zbatimit të ligjit nr.10 418, datë 21.4.2011 "Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor"", të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në fund të pikës 1.3 të sesionit I "Procedura e legalizimit të kapitalit" shtohen fjalët: "ose fotokopje e dokumentit të identifikimit të njehsuar me siglën e punonjësit të bankës".

2. Në pikën 2 të sesionit II "Falja e detyrimeve tatimore dhe doganore", fjalia e fundit ndryshohet me këtë përmbajtje:

"Lista e dërguar nga ILDKP-ja shërben për komisionet e administrimit të faljes (të përcaktuar në udhëzimin nr.12, datë 18.5.2011), bashkitë, komunat dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor (DPSHTRR), për të verifikuar me sistemin e të dhënave të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, nëse personat juridikë, të cilët janë subjekt i faljes sipas ligjit nr.10 418, datë 21.4.2011, kanë në përbërje të tyre zyrtarë, të cilët kanë aksione apo kuota kapitali.".

3. Pika 3 e sesionit II "Falja e detyrimeve tatimore dhe doganore" ndryshohet me këtë përmbajtje:

"3. Për të gjithë debitorët, të cilëve iu fshihen detyrimet tatimore e doganore, Komisioni i Administrimit të Faljes, bashkitë, komunat, DPSHTRR-ja, i bashkëlidhin procesverbalit, kopje të ekstraktit të QKR-së të subjektit debitor në të cilin të jenë emrat e personave të cilët kanë aksione apo kuota kapitali në atë kompani. Personat juridikë të cilët kanë në përbërje të tyre zyrtarë të cilët kanë aksione apo kuota kapitali nuk janë subjekt i faljes sipas ligjit nr.10 418, datë 21.4.2011.".

4. Në pikën 4 "Procedura e administrimit të nenit 26 pika 1", germa "b" ndryshohet si më poshtë:

"b) Komisioni menjëherë me hartimin e listës finale e analizon atë dhe pasi evidenton saktësinë e saj, përmes një procesverbali të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Komisionit, miraton faljen e këtij grupi debitorësh dhe vazhdimin e procedurës së shuarjes. Dega doganore procedon më pas me shuarjen e borxhit për debitorët, të cilët përfitojnë nga falja.".

5. Në pikën 5 "Procedura e administrimit të nenit 26, pika 2", bëhen këto ndryshime:

Germa "d" ndryshohet si më poshtë:

"d) Komisioni çdo fillim jave analizon dhe verifikon listën e këtyre debitorëve, kërkesat e tyre, si dhe evidenton nëse janë plotësuar kushtet e pagesës me qëllim përfitimin e faljes për pjesën tjetër të detyrimeve nga debitori. Komisioni harton një procesverbal të detajuar, në të cilin përcakton rastet që përfitojnë dhe ato që nuk përfitojnë, duke dhënë edhe sqarimet përkatëse. Për debitorët të cilët kanë plotësuar kushtin, Komisioni miraton faljen dhe vazhdimin e procedurës së shuarjes për këta debitorë. Ky procesverbal nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit. Dega doganore procedon më pas me shuarjen e borxhit për debitorët, të cilët përfitojnë nga falja.

Në rast të mosplotësimit të kushtit (pagesës jo të plotë të 50% të principalit apo mospagesës), debitori nuk miratohet për falje dhe shuarje të borxhit dhe njoftohet për këtë.".

Germa "e" shfuqizohet.

6. Në pikën 6 "Procedura e administrimit të nenit 26 pika 3" bëhen këto ndryshime:

Germa "d" ndryshohet si më poshtë:

"d) Komisioni çdo fillim jave analizon dhe verifikon listën e këtyre debitorëve, kërkesat e

tyre, si dhe evidenton nëse janë plotësuar kushtet e pagesës me qëllim përfitimin e faljes për pjesën tjetër të detyrimeve nga debitori. Komisioni harton një procesverbal të detajuar në të cilin përcakton rastet që përfitojnë dhe ato që nuk përfitojnë, duke dhënë edhe sqarimet përkatëse. Për debitorët të cilët kanë plotësuar kushtin, Komisioni miraton faljen dhe vazhdimin e procedurës së shuarjes për këta debitorë. Ky procesverbal nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit. Dega doganore procedon më pas me shuarjen e borxhit për debitorët, të cilët përfitojnë nga falja.

Në rast të mosplotësimit të kushtit (pagesës jo të plotë të 100% të principalit apo mospagesës), debitori nuk miratohet për falje dhe shuarje të borxhit dhe njoftohet për këtë".

Germa "e" shfuqizohet.

7. Në pikën 7 "Procedura e administrimit të nenit 26 pika 4" bëhen këto ndryshime:

Germa "a" ndryshohet si më poshtë:

"a) Në kuptim të nenit 26 pika 4 e ligjit nr.10 418, datë 21.4.2011 "Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor", do të kuptohen të gjithë personat, të cilët kanë në përdorim ose posedojnë automjete, të cilat kanë hyrë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë nën regjimin e lejimit të përkohshëm deri më 31 dhjetor 2010 dhe që nuk i kanë paguar detyrimet ndaj administratës doganore. Në këtë kategori nuk përfshihen emrat e individëve zyrtarë sipas listës së dërguar nga ILDKP-ja. Termi "automjetet", i përcaktuar në pikën 4 të nenit 26, i referohet mallit me kod doganor 8703, me përshkrimin "Autovetura dhe mjete të tjera transporti me motor kryesisht të projektuar për transportin e personave (të ndryshme nga ato të kreut 8702), përfshi makinat me portobagazh dhe makinat e garave.".

Në fund të germës "b" shtohet paragrafi:

"Paraprakisht debitorët mund të informohen pranë zyrës doganore të hyrjes ku është çelur regjimi i lejimit të përkohshëm mbi shumën që përfaqëson 50% të detyrimit (principalit).".

Germa "c" ndryshohet si më poshtë:

"c) Komisioni çdo fillim jave analizon, verifikon dhe evidenton kërkesat dhe mandat-pagesat e paraqitura sipas germës "b" më lart, dhe harton një procesverbal të detajuar në të cilin përcakton rastet që përfitojnë dhe ato që nuk përfitojnë, duke dhënë edhe sqarimet përkatëse. Për debitorët të cilët kanë plotësuar kushtin, Komisioni miraton faljen dhe vazhdimin e procedurës për zhdoganimin e automjetit, si dhe shuarjes për pjesën tjetër të detyrimeve. Ky procesverbal nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit. Dega doganore procedon më pas me njoftimin e këtyre debitorëve për miratimin e kërkesës së tyre për përfitim nga falja, si dhe për kryerjen e procedurës së zhdoganimit.

Për debitorët të cilët pas analizimit dhe verifikimit evidentohet se nuk kanë plotësuar kushtin e pagesës (rastet e pagesës jo të plotë të 50% të principalit apo mospagesës), debitori nuk miratohet për falje dhe shuarje të borxhit dhe njoftohet për këtë".

Germa "d" shfuqizohet.

8. Pas pikës 7 të sesionit II "Falja e detyrimeve doganore", shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:

"a) Në zbatim të shkronjës "b" të nenit 2 "Qëllimi i ligjit" i ligjit nr.10 418, datë 21.4.2011, në rastet e debitorëve ndaj administratës doganore, për të cilat administrata doganore ka filluar ose do të fillojë veprime procedurale në gjykatë ndaj prokurorisë, për pushimin e çështjeve, gjatë periudhës kohore të zbatimit të ligjit, të tilla veprime administrative pezullohen deri në datën 31.12.2011.

b) Në përfundim të datës 31.12.2011, administrata doganore shqyrton nëse të tillë debitorë kanë përfituar nga zbatimi i nenit 26 të ligjit. Nëse këta debitorë kanë përfituar, ndërpriten veprimet procedurale të përcaktuara në shkronjës "a" të kësaj pike, në rast të kundërt administrata doganore rifillon veprimet administrative.".

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode